




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 4738... Prot.

Fier, më 15/12/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit shkresor

PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “*Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre*”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 10 (dhjetë) ditë të aktit shkresor të Degës së Doganës Fier Nr.4541 Prot., datë 03/12/2025, me lëndë *“Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr.4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”, i mbajtur ndaj subjektit "Bimba Shoes" sh.p.k me NUIS M22511402N, me seli në Fier (Lagja "8 Shkurti" Rruga “Kastriot Muço”, pasuria 288 zona kadastrale 3984.*

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcitur - gjithsej 3 (tre) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

K R Y E T A R I

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES FIER

Nr. 4541 Prot.

Fier më: 03.12.2025

Lenda: Mbi zbatueshmerine e Udhezimit nr. 4 date 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik te Regjimit te Perpunitimit Aktiv”

BIMBA SHOES me NIPT M22511402N

Lagja "8 Shkurti" Rr. Kastriot Muco, pasuria 288 zona kadastrale 3984. FIER.

Ne vijim te attributeve te autoritetit doganor bazuar ne ligjin 104/2012 “Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise” dhe zbatueshmerise se Udhezimit nr 4 date 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik te Regjimit te Perpunitimit Aktiv” kreu XIV pika 1 Detyrimet e operatorit ekonomik ndaj Deges Doganore Mbikeqyrese Sektori i Mbikeqyrjes Doganore i Deges se Doganes Fier ka shqyrtuar dosjen tuaj dhe ka kryer verifikimet perkatese ne sistemin Oracle

Sa i takon autorizimit nr. 8624/1 date 25.02.2022 situata nga sistemi Oracle eshte e pasqyruar sipas tabelës me poshte

PROCEDURA	VLERA (EURO)	PESHA (KG)	TAKSA (ALL)
5100 (import)	315,827	13,774.08	114,318
3151 (eksport)	326,303	11,903.48	-
9351 (mbetje)		1,163	
Diferenca (Importe-Eksporte- mbetje)	-10,476	708	114,318

Nga verifikimi ne sistemin Oracle rezulton se vlere materiale e mallit te eksportuar eshte me e madhe se vlere e mallit lende e pare te importuar me nje difference prej 10,476 Euro me shume ne eksport. Nderkohe keni gjendje malli lende e pare pa i dhene destinacion ne sasine 708 kg. Difference kjo e pajustificuar nga ana juaj.

Gjithashtu bazuar në Udhëzimin nr 4 date 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” kapitulli i IX pika 4 “Mbyllja e regjimit të përpunimit aktiv”, ju nuk keni dorëzuar Aneksin 8 “Dokument i mbylljes së Regjimit”, e cila sjell mosrespektimin e kushteve të autorizimit.

Keto shkelje klasifikohen sipas neneve 250/1/a dhe 252/c “Mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim” dhe sanksionohen sipas nenit 257/1/b të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Sa i takon Takses Doganore TDP malli i importuar ka ardhur pa certificate origjine EUR1 duke gjeneruar takse doganore preferenciale në vlerën 100,597 leke. Ju duhet të jepni sqarimet e duhura sa i takon mospageses së Takses Doganore Preferenciale.

Sa i takon autorizimit nr. 19157/1 date 13.03.2023 situata nga sistemi Oracle është e pasqyruar sipas tabelës me poshtë

PROCEDURA	VLERA (EURO)	PESHA (KG)
5100 (import)	129,381	14,583
3151 (eksport)	129,381	13,240
Diferenca (Importe-Eksporte-mbetje)	-	1343

Nga verifikimi në sistemin Oracle rezulton se keni gjendje malli lende e pare pa i dhene destinacion në sasinë 1343 kg. Diference kjo e pajustificuar nga ana juaj.

Te gjendur në keto kushte Dega e Doganës Fier bazuar në Ligjin 102/2014 date 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” sipas nenit 74 “Borxhi doganor i lindur nepermjet mospermbushjes”, nenit 252/c “Mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28” dhe nenit 257/1/a ka llogaritur detyrimin në shumën:

Përlllogaritja e detyrimeve:

$129,381 \text{ euro} / 14,583 \text{ kg} = 8.87 \text{ euro/kg lende e pare}$

$\text{Sasia } 1343 \text{ kg} * 8.87 \text{ Euro/kg} * 96.7 \text{ Kursi} = 1,152,195 \text{ leke}$

$\text{Detyrimi} = 1,152,195 \text{ lekë} * 20\% = 230,439 \text{ leke}$

$\text{Penalitet} = 230,439 * 2 \text{ fishi} = 460,878 \text{ leke}$

$\text{Totali Detyrim} + \text{Penalitet} = 691,317 \text{ leke}$

Gjithashtu bazuar në Udhëzimin nr 4 date 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” kapitulli i IX pika 4 “Mbyllja e regjimit të përpunimit aktiv”, ju nuk keni dorëzuar Aneksin 8 “Dokument i mbylljes së Regjimit”, e cila sjell mosrespektimin e kushteve të autorizimit.

Keto shkelje klasifikohen sipas neneve 250/1/a dhe 252/c “Mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim” dhe sanksionohen sipas nenit 257/1/b të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Per sa me siper, ne zbatim të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i RSH-se”, neni 23 “Dhënia e Informacionit Autoriteteve Doganore”, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, ju duhet të paraqisni të gjitha informacionet e nevojshme shoqëruar me material dhe dokumentacion përkatës ku të shpjegoni gjithë situatën e sipërpermendur.

KRYETAR

Kosta Vjero

